

## VENDIM

Nr. 390, datë 6.6.2012

### PËR PËRCAKTIMIN E SUBJEKTEVE QË KANË TË DREJTËN E AKSESIT NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Subjektet që kanë të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë dhe që paraqesin kërkesë për pajisjen me kod hyrës, janë:
  - a) Ministria e Brendshme;
  - b) Prokuroria e Përgjithshme;
  - c) Prokuroritë pranë gjykatave dhe rretheve gjyqësore;
  - ç) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
  - d) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
  - dh) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
  - e) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
  - ë) Bashkia e Tiranës;
  - f) Noterët.
2. Përdorimi i regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP) udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit, mbrojtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
3. Regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme (ALBSReP), aksesohet vetëm nga një person i caktuar, duke njoftuar paraprakisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i cili pajiset me kodin e hyrjes. Në asnjë rast kodi hyrës nuk mund t'u bëhet i ditur personave të tretë, të ndryshëm nga personi i caktuar, duke njoftuar paraprakisht pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
4. Noterët aksesojnë regjistrin e pasurive të paluajtshme (ALBSReP) për të lexuar dhe printuar informacionin për dokumentet digjitale që tregojnë gjendjen juridike të pronës.
5. Subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, kanë detyrimet e mëposhtme:
  - a) të njoftojnë të dhënat e personit të vetëm që do të aksesojë regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP) dhe që do të disponojë kodin e hyrjes në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme;

- b) të identifikojnë pajisjen fundore, nga e cila aksesohet regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme(ALBSReP);
  - c) të përdorin regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave të tyre funksionale dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale;
  - ç) të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisje të identifikimit personal dhe të aksesojnë regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP), vetëm nëpërmjet këtyre pajisjeve;
  - d) të paguajnë shpenzimet e domosdoshme për sigurimin e aksesit dhe për mirëmbajtjen e sistemit në lidhje në sigurimin e aksesit.
6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 10.6.2012.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**